



REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 228/26 Dt. 21.05.2026



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) nenit 1 paragrafi 2, nenit 3 paragrafi 2 dhe nenit 14 paragrafi 1.2 të Rregullores Komunale nr. 001-011-201, datë 03.01.2024, për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Transfereve dhe Granteve, si dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, pas kërkesës 01-030 nr. 43154, të datës 14.04.2026, të Adem Krasniqit, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për lejimin e mjeteve financiare

1. Miratohet kërkesa 01-030 nr. 43154, datë 14.04.2026, e Adem Krasniqit nga fshati Jeshkovë, Komuna e Prizrenit, për lejimin e mjeteve financiare për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të tij, i cili është diagnostikuar me [REDACTED] kështu që, për këtë qëllim dhe në emër të mbulimit të pjesshëm të shpenzimeve të mjekimit (trajtimit mjekësor) lejohen mjetet financiare në shumën prej 600.00 € (gjashtëqind euro).
2. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës—pozicioni i subvencioneve dhe transfereve i Zyrës së Kryetarit të Komunës.
3. Obligohet Drejtoria për Ekonomi dhe Financa për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj



- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Drejtorisë së Shëndetësisë,
 - Të lartcekurit,
 - Arkivës së Kryetarit.